



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1093/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Vedat Dreshaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar apeli Anr.1093/2021 i datës 08.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, Vedat Dreshaj, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në Vendvotimet VV 0602C/02R dhe VV 0606C/01R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në Komunën e Istogut, në Vendvotimet VV 0602C/02R dhe VV 0606C/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimet si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit Anr.1093/2021 i datës 08.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, Vedat Dreshaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

(KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në Vendvotimet VV 0601C/04R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021 ka pranuar apelin Anr.1093/2021 (përmes postës të datës 04.11.2021), i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut Vedat Dreshaj, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në të cilën pretendon se në Vendvotimet VV 0601C/04R, VV 0602C/02R dhe VV 0606C/01R në Formularët e Rezultatit të Kandidatit numri i tij i votave është përmirësuar. Si dëshmi krahas apelit i ka bashkangjitur Formularët e Rezultatit të Kandidatit.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që PZAP të aprovojë apelin dhe ta urdhërojë KQZ-në që të hap kutitë me qëllim të rinumërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut Vedat Dreshaj, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekur, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është pjesërisht i bazuar.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Vendvotimit të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ngase rezulton se nga Formularët e Rezultatit të Kandidatit të bashkangjitur si provë vërehet se ka ndërhyrje tek numri total i votave tek numri i kandidatit Vedat Dreshaj me numrin 26 pasi që vërehet se janë bërë përmirësime në numra.

Andaj ky panel, vlerësoi se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e rinumërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e rinumërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos

procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Andaj mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut Vedat Dreshaj nga Subjekti Politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Istogut me të cilin kërkon rinumërimin e votave për vendvotimin VV 0601C/04R është i pa bazuar për faktin se për të njëjtin vendvotim, KQZ-ja veç e ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruar nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1093/2021 më datën 09.11.2021.

Kryesuesi e Panelit

Burim Adem



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.